

## Kosovë

### Raporti Ndërkombëtar mbi Liritë Fetare 2008

Lëshuar nga Zyra për Demokraci, të Drejta Njerëzore dhe Punë

Kushtetuta e cila hyri në fuqi me 15 qershor 2008, siguron liri fetare, dhe ligjet e politikave të tjera kanë kontribuar në përgjithësi që feja të praktikohet në mënyrë të lirë.

Qeveria në përgjithësi e ka respektuar lirinë fetare në praktikë. Nuk ka pasur nga qeveria ndonjë ndryshim të theksuar në statusin e respektit për liritë fetare gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport. Dhuna në shoqëri është zvogëluar dukshëm por tensioni ndërmjet komuniteteve mbetet i lartë, posaqërisht pas shpalljes së pavarësisë të vendit me 17 shkurt 2008. Edhe pse diskriminimi dhe dhuna në shoqëri duken të jenë në përgjithësi me motive etnike, lidhja e ngushtë ndërmjet përkatësisë etnike dhe fetare e bëri të vështirë që të përcaktohet nëse ngjarjet ishin të motivuara nga dallimet etnike apo fetare.

Si pjesë e politikës së saj të përgjithshme për të promovuar të drejtat njerëzore, qeveria e SHBA-ve e diskuton lirinë fetare me Qeverinë Lokale, Administratën e Përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK) dhe përfaqësuesit fetar. Qeveria e SHBA-ve ka intervenuar në raste specifike për të siguruar mbrojtjen dhe riparimin e dëmeve të vendeve fetare që i përkasin kishës ortodokse serbe dhe vendeve tjera patriarkale.

#### **Pjesa I. Demografia Fetare**

Vendi ka një sipërfaqe prej 10,906 kilometra katrorë dhe një popullsi prej 2 milion banorësh, edhe pse regjistrimi i fundit i besueshëm është bërë në vitet 1980. Feja myslimane dominon më së shumti të cilës i përkasin shumica e popullsisë etnike shqiptare; komuniteti boshnjak, goran dhe turk; si dhe disa antarë të komunitetit rom/ashkali/egjiptian; megjithatë feja nuk është faktor i rëndësishëm në jetën publike. Retorika fetare nuk ishte edhe aq e pranishme në komunikimet publike të komuniteteve myslimane, pjesëmarrja nëpër xhami ishte e vogël dhe shfaqja publike e kulturës dhe veshjeve konservative islame ishte minimale. Popullsia serbe në vend, që vlerësohet të jetë 100,000 deri në 120,000 janë në përgjithësi serb ortodoks. Grupet që përbëjnë më pak se 5 përqind të popullsisë përfshijnë katolikët dhe protestantët romë. Komunitetet katolike janë të përqendruara rreth kishave katolike në Prizren, Klinë dhe Gjakovë. Protestantët kanë numër të vogël të popullsisë në shumicën e qyteteve, me përqendrim më të madh në Prishtinë.

#### **Pjesa II. Statusi i Lirisë Fetare**

##### *Korniza Ligjore/Politikat*

Kushtetuta, e cila hyri në fuqi me 15 qershor 2008, përmbanë konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat njerëzore, duke përfshi dispozitat që mbrojnë liritë fetare dhe ndalojnë diskriminimin në baza fetare dhe etnike. Gjatë pjesës më të madhe të periudhës kohore që mbulohet me anë të këtij raporti, vendi ishte nën administrimin e autoritetit civil të UNMIK-ut, sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244. Qeveria, megjithatë, gradualisht mori përsipër autoritetin dhe përgjegjësitë në pjesën më të madhe të vendit pasi që Kushtetuta hyri në fuqi. Qeveria dhe UNMIK-u promovuan respektin për lirinë fetare dhe tolerancën gjatë administrimit të vendit dhe zhvillimit të programeve për rindërtimin dhe zhvillimin e vendit. Ligji i vitit 2006 mbi Liritë Fetare siguron të drejtën për lirinë e të shprehurit, parimeve dhe fesë për të gjithë banorët pa marrë parasysh bindjet e tyre fetare. Ky ligj siguron ndarjen e komuniteteve fetare nga institucionet publike dhe të drejta e obligime të barabarta për të gjitha komunitetet fetare, si dhe thekson se nuk ka ndonjë fe zyrtare në vend. Ligji poashtu definon dispozita të veçanta ligjore që sigurojnë të drejta dhe obligime të barabarta ndaj të gjitha komuniteteve fetare.

Kuvendi kombëtar kaloi ligjin mbi festat kombëtare që hyri në fuqi me 15 qershor 2008.

Sipas ligjit, Qeveria i njeh si festa zyrtare disa por jo të gjitha festat ortodokse, myslimane dhe katolike, duke përfshirë këtu Eid al-Adha, Pashkët Ortodokse, fillimin e muajit të Ramazanit, Eid al-Fitr, Festa

ortodokse e Zonjës Madhe (ngritja e Virgjes Mari në Qiell), Krishtlindjet ortodokse dhe Krishtlindjet perëndimore.

Nuk ekzistojnë rregullore mandatore për regjitrime të grupeve fetare, megjithatë, për blerjen e pronës ose për të marrë fonde nga UNMIK-u apo organizatat tjera ndërkombëtare, grupet fetare duhet të regjistrohen pranë Ministrisë për Shërbime Publike si organizata joqeveritare (OJQ). Udhëheqësit fetar janë ankuar duke kërkuar që të kenë status të veçantë nga OJQ-të.

#### *Kufizimet e Lirisë Fetare*

Qeveria, UNMIK-u dhe Forcat paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO-ja (KFOR) në përgjithësi i kanë respektuar liritë fetare në praktikë. Nuk ka pasur ndryshim në statusin e respektit për liritë fetare nga ana e qeverisë gjatë periudhës kohore të mbuluar nga ky raport. Megjithatë, protestantët kanë vazhduar të raportojnë se kanë qenë të diskriminuar sa i përket qasjes në media, posaqërisht nga ana e Radios dhe Televizionit publik të Kosovës (RTK). Protestantët poashtu kanë raportuar që komuna e Deçanit, duke cituar reagime negative nga qytetarët vendas, nuk ju ka lëshuar lejen për ndërtimin e kishës në një tokë private që e kishin blerë ata dhe që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor e ka mbështetur vendimin. Çështja ligjore rreth lëshimit të kësaj leje ndërtimi gjendej para Gjykatës Supreme në fund të periudhës kohore që e mbulon ky raport.

Protestantët poashtu raportuan që mungesa e liritë nga taksat për importimin e ndihmave humanitare të donuara i pengon përpjekjet e tyre. Protestantët deklaruan që televizioni i RTK-së specifikisht nuk pranoi të raportonte mbi fenë protestane. Për më shumë, protestantët pohuan për diskriminim institucional nga ana e qeverisë qendrore dhe komunale. Për shembull, ata u ankuan që nuk u lejuan të regjistronin pronën në emër të kishës së tyre dhe krijonin vendvarrime për besimtarët protestant.

Legjislatura dhe rregulloret arsimore krijojnë hapsirë për ndarjen e sferës fetare nga ajo publike.

Sipas një ligji të vitit 2002 ku kërkohet që institucionet arsimore të përmbahen nga udhëzimet fetare apo veprimtaritë e tjera që promovojnë ndonjë fe specifike, Ministria e Arsimit e ndaloi mbajtjen e shallave në kokë. Ministria vazhdoi zbatimin e këtij ndalimi, posaqërisht nëpër shkollat ku uniforma është obligative, përkundër një opinion të lëshuar nga Ombudspersoni në vitin 2004, që rregulli duhet të vlejë vetëm për mësuesit dhe zyrtarët e shkollës e jo për studentët. Me 26 shkurt 2008, Ombudspersoni pranoi një ankesë nga një nxënëse e shkollës së mesme në komunën e Vitisë, të cilës drejtori i shkollës i kishte thënë që të mos shkonte në shkollë me shallë të kokës. Ombudspersoni kërkoi nga Ministria e Arsimit që nxënësjë të lejohej të vijonte shkollën me shallë koke dhe që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen, por deri në fund të periudhës raportuese ata nuk morën ndonjë përgjigje.

Me një rast tjetër, dy femra në Prizren u ankuan se kishin aplikuar për pozita të arsimtareve nëpër shkolla të mesme por nuk ishin punësuar për shkak të bindjeve të tyre fetare dhe faktit që mbanin shalla koke.

Në të dyja rastet Ombudspersoni i këshilloi ankuesit që të ndiqnin procesin ligjor të ankimit.

Nuk janë raportuar raste të të burgosurve apo të arrestuarve në baza fetare në vend.

#### *Konvertimi Fetar i Imponuar*

Nuk janë raportuar raste të konvertimit fetar të imponuar, përfshirja e qytetarëve amerikan që ishin rrëmbyer apo larguar ilegalisht nga Shtetet e Bashkuara, apo refuzimi që të lejohet kthimi i qytetarëve të tillë në Shtetet e Bashkuara.

#### *Përmirësimet dhe Zhvillimet Pozitive sa i përket Lirisë Fetare*

Me 6 mars 2008, si pjesë e përkushtimit ndaj Propozimit gjithpërfshirës për Përcaktimin e Statusit të Kosovës, që njihet si "Plani i Ahtisaarit", kuvendi kombëtar pranoi ligjin për themelimin e zonave speciale mbrojtëse (ZSM) rreth 47 objekteve fetare dhe kulturore në vend, prej të cilave pothuajse të gjitha ishin kisha ortodokse, duke përfshirë këtu Manastirin e Lartë të Deçanit, ZSM e të cilit ishte përcaktuar më parë nga UNMIK-u.

Komisioni multietnik për Implementimin e Rindërtimit (KIR) përfundoi rinovimet ekstenzive në 8 nga 35 objektet e dëmtuara në vitin 2004. Kjo punë përfshinte ndërtimet shtesë në disa nga objektet e identifikuar më parë si dhe disa objekte të reja, përfshirë këtu edhe kishën e Shën Andreut në Podujevë dhe kishën e Shën Pjetrit dhe Palit në Istog. KIR planifikonin të përfundonin pjesën më të madhe të punëve ndërtimore deri në fund të vitit 2008, edhe pse përpjekjet e tyre vazhdonin të ngadalësoheshin për shkak të ndryshimeve përbrenda dhe mospajtimeve me qeverinë serbe.

### *Pjesa III. Keqtrajtimet shoqërore dhe Diskriminimi*

Dhuna shoqërore është zvogëluar dukshëm, por tensioned ndërmjet komuniteteve mbeten të larta, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së vendit më 17 shkurt 2008. Diskriminimi dhe dhuna shoqërore në përgjithësi kishin motiv etnik, por ndërlidhja e ngushtë ndërmjet përkatësisë etnike dhe fetare e bëri të vështirë që të përcaktohet nëse ngjarjet kishin motiv dallimet etnike apo fetare. Përderisa shumica e shqiptarëve të Kosovës e identifikojnë veten si mysliman, emri ka më shumë theks kulturor se fetar. Serbët e Kosovës e identifikojnë veten me kishën ortodokse serbe (KOS), që i definon jo vetëm perspektivat e tyre fetare por edhe ato kulturore dhe historike. Shqiptarët e krishterë ortodoks dhe katolik nuk kanë hasur në kurrfarë diskriminimi nga shqiptarët tjerë mysliman të Kosovës.

Incidente të shumta janë raportuar të jenë drejtuar kundër komunitetit dhe pronës serbe ortodokse, duke përfshirë këtu kërcënime, plaçkitje dhe shkatërrime. Sipas raporteve të Shërbimit Policor të Kosovës, më 19 tetor 2007, tre burra të armatosur e kanë kërcënuar një shqiptar të Kosovës që bënte roje para KOS në Gjakovë. Më 29 korrik 2007, një burrë shqiptar i Kosovës verbalisht ju kërcënuar një murgeshës së KOS në manastirin e Sokolicës dhe një ushtari grek të KFOR-it ju kërcënuar me sëpatë. Policia e arrestoi të dyshuarin por prokurori lokal urdhëroi që ai të lirohej deri në ditën e gjykimit. Deri në fund të periudhës së raportimit, ende nuk ishte caktuar data e gjykimit. Për dallim nga raporti i mëparshëm, nuk janë raportuar raste të gjatjeve me gurë apo sulmeve tjera kundër klerikëve të KOS që udhëtonin jashtë manastireve të tyre. Megjithatë, në autobusët me të cilët udhëtonin pelegrinët serb nga Serbia për të marrë pjesë në ceremonitë fetare të manastirit të Deçanit shpeshherë janë hedhur gurë, zakonisht nga ana e fëmijëve vendas. Në komunat perëndimore të Pejës, Deçanit, Gjakovës, Istogut, Klinës dhe Skënderajt si dhe në pjesën jugore të Mitrovicës (pjesët që përfshijnë manastiriet e Patriarkut të Pejës, Deçanit, Goricit, Budishavcit dhe Devicit), klerikët kanë kërkuar dhe ju është siguruar përcjellja e KFOR-it. Klerikët deklaruan se nuk kanë mundur të vizitonin anëtarët e kishës në pjesët perëndimore (ku gjenden vendet e shenjta më me rëndësi të KOS) pa përcjellje dhe anëtarët pohuan se siguria e tyre është e kërcënuar dhe hasin në pengesa për të vizituar vendet e shenjta. Është raportuar se priftërinjtë dhe murgeshat nëpër disa manastire nuk kanë shfrytëzuar pjesë të caktuara të pronave të manastireve – shpeshherë tokën jashta mureve të manastirit – për shkaqe sigurie.

Problemet në vendet e shenjta të KOS vazhdojnë, edhe pse në disa raste ka qenë vështirë të përcaktohet nëse incidentet janë motivuar nga tensionet ndëretnike apo lakmia dhe plaçkitjet kriminale. Më 25 tetor 2007 është zbuluar se hajnat kishin vjedhur pjesë të kulmit nga plumbi në vlerë prej \$15,600 (€10,400) nga kisha e Shën Kiriakut dhe nga kisha e Virgjes së Shenjtë Levishka, të dyja këto në Prizren. RIC e ka vazhduar rindërtimin në të dy këto kishat; qeveria i dënoi ashpër plaçkitjet dhe financoi riparimet.

Më 18 gusht 2007, persona të paignifikuar e ngjyrosën me të zezë një kryq në një KOS në Gjilan dhe vizatuan grafitet anti-serbe nëpër muret e kishës.

Eshte pse protestantët paraprakisht kishin raportuar një përmirësim të vogël në gjendjen e tyre të përgjithshme, ata raportuan se kishin vuajtur më shumë nga dhuna dhe diskriminimet gjatë kësaj periudhe të raportimit. Në nëntor të vitit 2007, [webfaqja](#) e degës së Gjakovës së Komunitetit Islamik të Kosovës e publikoi listën e emrave të priftërinjëve dhe misionarëve Protestant, duke përfshirë këtu shqiptarët e Kosovës dhe misionarët e huaj. Në listë ishin përfshirë emrat e familjeve, adresat, numrat e telefonave dhe emrat e kishave apo organizatave të tyre misionare përkatëse. Pasi protestoi komuniteti ndërkombëtar, Komunitetit Islamik e hoqi atë përmbajtje të [webfaqes](#). Disa protestantë individual pohuan se ishin diskriminuar verbalisht. Përderisa disa kisha protestante janë thyer dhe plaçkitur gjatë periudhës së raportimit, udhëheqësit e këtij komuniteti nuk e konsideronin se këto incidente kanë qenë të motivuara nga diskriminimi fetar.

Disa incidente janë raportuar të jenë drejtuar kundër komunitetit mysliman, përfshirë këtu vjedhjet, vandalizmat dhe kërcënimet. Më 22 prill 2008, zyrtari i SHPK-së gjatë një patrollimi rutinor në Gjilan raportoi se kanë zbuluar që më se 30 pllaka të varrezave myslimane në një varrëze lokale ishin dëmtuar. Më 5 shkurt 2008, imami i xhamisë së Sejdi Begut në Prizren raportoi në SHPK se të dyshimtit të panjohur kishin vjedhur një mbajtëse qirinjësh të vjetër 300 vjet gjatë një lutje të pasditës. Hetimet policore ishin në zhvillim e sipër në fund të periudhës raportuese. Më 28 shtator 2007, SHPK-ja raportoi se një qytetar i kishte informuar që një njeri i maskuar me një rrip në dorë i kishte keqtrajtuar dy burra në xhaminë e fshatit të Jashanicës së ultë në Klinë gjatë lutjeve të mbrëmjes. I dyshimti nuk u kap. Sipas

SHPK-së, imami dhe disa fshatarë besonin se qëllimi i këtij incidenti ishte ti frikësonte të rinjtë që të largoheshin nga feja Islame.

Udhëheqësit katolik raportuan se kishin marrëdhënie të mira me komunitetin mysliman por pak komunikim bilateral me udhëheqësinë e KOS. Udhëheqësit e KOS dhe ata të fesë së Krishterë besojnë për njëri tjetrin se janë tepër të politizuar. Komuniteti mysliman poashtu raportoi për marrëdhënie të mira me udhëheqësinë katolike por komunikim të kufizuar me komunitetin ortodoks. Planet për mbajtjen e sërishme të një konference ndërfaqetare që u mbajt në vitin 2006 me organizimin e Kishës Norvegjeze mbetën në fazën e planifikimit për shkak të mosinteresimit të udhëheqësisë së KOS për të marrë pjesë.

Në fillim të vitit 2008, SHPK-ja adoptoi procedura të reja të operimit për të ofruar mbrojtje më të madhe për vendet kulturore dhe fetare serbe. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, qeveria aprovoi \$75,000 (€50,000) për të financuar zgjerimin dhe përmirësimin e mbrotjes së SHPK-së, përfshirë këtu edhe kamerat e sigurisë dhe ndriqimin, në disa nga vendet ortodokse serbe më të ndjeshme, të cilat u përcaktuan nga vet zyrtarët e KOS. Zyrtarët e SHPK-së deklaruan se kishin vendosur roje për 24 orë në ditë para kishës së shën Nikolasit në Prishtinë. Ata poashtu raportuan se po patrollonin afër vendeve të tjera kulturore serbe. KFOR-i raportoi se po ruanin manastiret e Pejës, Deçanit, Budisavcit, Goriocit, Devicit, Arkangjelit dhe Zocistës.

Me 25 shkurt 2008, Jeton Mulaj, i dyshimtë për gjuajtjen e një granate dore në manastirin e Deçanit në mars të vitit 2007, ju dorëzua vullnetarisht policisë. Me 19 mars 2008, Prokurori Special e hapi aktakuzën pranë Gjykatës së Qarkut të Pejës. Në fund të periudhës që e mbulon ky raport, Mulaj ende ishte nën arrest duke pritur gjykimin.

Udhëheqësit Mysliman, Katolik dhe disa Ortodoks tentuan të promovonin tolerancë dhe paqe në sferat fetare dhe politike.

#### **Pjesa IV. Politikat e Qeverisë së SHBA-ve**

Qeveria e SHBA-ve e diskuton lirinë fetare me qeverinë, UNMIK-un dhe përfaqësuesit fetar si pjesë e politikës së saj për të promovuar tolerancë etnike dhe fetare. Liria fetare ishte një çështje kritike në rezolutën e statusit final të vendit, si për mirëqenien afat-gjatë të komunitetit serb ashtu edhe për sigurinë e vendeve fetare të KOS. Shumë zyrtarë të lartë të qeverisë së SHBA-ve dhe zyrtarë të lartë ushtarak vazhduan vizitat në vend në ndërlidhshmëri me procesin e statusit final dhe u takuan me udhëheqës politik dhe fetar për të vlerësuar situatën dhe të nxisin rindërtimin dhe progresin drejt një shoqërie multietnike.

Zyrtarët amerikan poashtu ishin në kontakt të ngushtë dhe u takuan rregullisht me udhëheqësit fetar të KOS, myslimanëve, katolikëve dhe komunitetit protestant për të diskutuar rreth shqetësimeve të tyre dhe të promovojnë bisedime me mirëbesim. Zyrtarët e SHBA-ve nxitën bisedimet ndërmjet anëtarëve të KOS dhe anëtarët shqiptar etnik të qeverisë. Qeveria e SHBA-ve vazhdoi të përkrahte qeverinë dhe UNMIK-un në rindërtimin e ndërtesave fetare që u dëmtuan në trazirat ndëretnike të vitit 2004 dhe vazhduan të intervenojnë në mënyrë aktive te zyrtarët qeveritar në emër të interesave të KOS në rastet kur të drejtat e KOS u kërcënuan apo u shkelen. Forcat amerikane paqeruajtëse të KFOR-it punuan në parandalimin e dhunës etnike dhe fetare dhe i ruajtën vendet fetare.

Qeveria amerikane vazhdoi ti financonte 220 zyrtarë të policisë së SHBA-ve që angazhohen pranë kontigjentit të policisë civile të UNMIK-ut dhe siguruan përkrahje të vazhdueshme për SHPK-në, me të dyja këto shërbime duke punuar në parandalimin e dhunës etnike dhe fetare. Diplomatatë amerikan punuan me personelin ushtarak amerikan që u angazhuan pranë KFOR-it për të mbrojtur vendet fetare në zonën e përgjegjësive të ushtrisë amerikane dhe në mënyrë aktive i promovuan përpjekjet për rindërtimin e kishave të dëmtuara apo të vandalizuara. Përfaqësuesit e qeverisë së SHBA-ve intervenuan për të mbrojtur ZSM të manastirit të Deçanit dhe e inkurajuan riparimin e kishës së shën Gjonit në Pejë. Punët riparuese u ndanë në shtatë projekte për rindërtim në shumë prej 1 milion dollarësh të grantit të dhënë nga qeveria e SHBA-ve, që ishte pjesë e përpjekjeve masive të UNESCO-s për të ruajtur trashëgiminë kulturore të vendit. Për periudhën nga shtatori 2007 deri në gusht 2008, Departamenti i Shtetit i obligoi 3.1 milion dollar në financimin e programeve për kthimin e serbëve ortodoks, romëve mysliman dhe ortodoks, boshnjakëve mysliman, dhe komuniteteve tjera minoritare që ikën nga dhuna ndëretnike në periudhën e pas konfliktit të viteve 1998-99. Ambasada amerikane në Prishtinë, bashkë me

ambasadën amerikane në Beograd, dhuroi donacion prej \$65,000 në verën e vitit 2007 për një ikonostat të ri në kishën e Shën Nikollës në Prishtinë.

E lëshuar me 19 shtator 2008